REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr 61, datë 26 /06 /2025

''Për ndryshimin e llojit të transferimit të tokave që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive) me nr.pasurie 420,nr.421 zonë kadastrale 1631,me vendodhje në Floq, pasuritë nr.772,nr.774,nr.768,nr.766.nr.777 zonë kadastrale 2063 ,me vendndodhje në Kamenicë,NjA.Mollaj si dhe pasuritë me nr.584/7,nr.584/8 zonë kadastrale 1473 me vendndodhje në Dërsnik, NjA.Voskop, nga përdorimi në pronësi të Bashkisë Korçë sipas genplanit bashkëngjitur"

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Pergjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe DPPTMK bazuar në nenin 9, pika 1, nënpika 1.2, shkronja "a" dhe "c", nenit 54 të Ligjit Nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" i ndryshuar, Ligjit Nr. 8744, datë 22.02.2001 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*" i ndryshuar ,VKM nr.500 datë 14.08.2001 "*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave organeve të qeverisjes vendore*" si dhe Ligjin Nr. 20/2020 "*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*" neni 40 :

V E N D O S I

1. Miratimin për fillimin e procedurave për ndryshimin e llojit të transferimit të tokave që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive) referuar VKM-së nr.1057 datë 16.07.2008 "*Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Mollaj të Qarkut të Korçës*" e ndryshuar,pasuritë nr.420,nr.421 zonë kadastrale 1631,me vendodhje në Floq, pasuritë nr.772,nr.774,nr.768,nr.766.nr.777 zonë kadastrale 2063 ,me vendndodhje në Kamenicë,Njësia Administrative Mollaj nga përdorimi në pronësi të Bashkisë Korçë sipas genplanit bashkëngjitur.

2. Miratimin për fillimin e procedurave për ndryshimin e llojit të transferimit të tokave që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive) dhe VKM-së nr.1641 datë 17.12.2008 "*Për miratimin e listës përfundimtare*

të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Voskop të Qarkut të Korçës" e ndryshuar, pasuritë me nr.584/7,nr.584/8 zonë kadastrale 1473 me vendndodhje në Dërsnik, Njësia Administrative Voskop, nga përdorimi në pronësi të Bashkisë Korçë sipas genplanit bashkëngjitur.

3. Qëllimi i transferimit është përdorimi i këtyre pronave në fushën e e bujqësisë dhe ushqimit (toka produktive) .
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerzore si dhe Drejtoria e Përgjithshme Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave , Bashkia Korçë.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike(sipas përcaktimeve të nenit 55,pika 6, të Ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 22 vota

Vota Pro 22

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 27-06-2025

KRYETAR

ANA VERUSHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KORÇË